



Viti i IX-të i Botimit, Nr.2,
Dhjetor 2018

PROTOTIPI PSIKODINAMIK DHE PSIKOLINGUISTIKA DINAMIKE: NDIKIMI I SISTEMIT TË NDËRVEPRIMIT SOCIAL NË PROTOTIPIN PSIKOLINGUISTIK TË INDIVIDIT

Silva Ibrahimimi*; Vera Ostreni Halili**; Elisabeta Kafia*

*Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, Albanian University, Tiranë

**Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University, Tiranë

Adresë kontakti: silva.ibrahimi@yahoo.it

Përmbledhje

Fjalimi është një veprimtari kognitive-motore e thjeshtë, e cila dallon njerëzit nga speciet e tjera dhe zhvillohet brenda një rrjeti të gjerë të strukturave cerebrale, kortikale dhe nënkortikale. Gjuha nënkupton marrëdhënien e njeriut me botën e tij, ndërsa psikolinguistika është procesi dinamik gjuhësor që të çon në një lidhje të ndërsjellë me botën e jashtme dhe me tjetrën, e cila është e ndryshme nga vetja. Në historinë e mendimit psiko-pedagogjik shkencor shqiptar ka prova që dëshmojnë përpjekjet dhe kontributet për të kuptuar dhe interpretuar fenomenet dhe problemet që lidhen drejtpërsëdrejti me formimin dhe edukimin e nxënësve të moshave të ndryshme shkollore. Kuptimi i tematikave komplekse gjuhësore, i komunikimit dhe i marrëdhënieve, lidhet jo vetëm me shterimin e një përkufizimi të vetëm, por edhe me aftësinë për të marrë në konsideratë rrethanat që i bëjnë ato një sistem referimi social-etnik me kontributin e referencave kryesore, si: psikologjia gjuhësore, filozofia e gjuhës, gjuhësia dhe semiotika, analiza e nivelit kognitiv dhe aspekteve fenomenologjike në një dimension të përditshëm, por edhe në formën e kuptimeve, konceptit të reciprocitetit, konotacionit social dhe procesit dinamik në tërësi.

Fjalë çelës: *psikolinguistikë, komunikim, mendim psiko-pedagogjik, edukim i konstruktiv psiko-gjuhësor.*

DYNAMIC PSYCHOLINGUISTICS : THE IMPACT OF THE SOCIAL INTERACTION SYSTEM IN THE INDIVIDUAL PSYCHOLINGUISTIC PROTOTYPE

Abstract

Speaking is a cognitive - motor activity apparently simple, which differentiates men from other animals and is made possible by a vast network of cerebral, cortical and subcortical structures. Language implies the relationship of the human being to his world while Psycholinguistics is the dynamic language process that leads to a mutual connection with the world external and with the other, which is other than self. In the history of Albanian psycho-pedagogical thinking there are evidences that reveal the efforts and contributions to understand and interpret the phenomena and problems directly related to the development and education of students of different school ages. The discussion of complex linguistic topics, communication and relationships is related not only to the exhaustion of the definition, but also the ability to take into consideration the circumstances that make them a social-ethnic reference system with the contribution of main references such as linguistic psychology, philosophy of language, linguistics and semiotics, cognitive level analysis and phenomenological aspects in a daily dimension, but also in the form of meanings, concept of reciprocity, social connotation and the dynamic process in the whole.

Key words: *psycholinguistics, communication, psycho-pedagogical thinking, education of psycho-linguistic construct.*

Hyrje

Në përpjekjet e tyre për të kuptuar identitetin njerëzor, specialistët e fushave të psikologjisë dhe sociologjisë kanë përdorur qasje dhe pikëpamje të ndryshme.

Argumentet e tyre variojnë që nga pikëvështrimet mbi përfaqësimin krejtësisht intrapsikik dhe makro social (1), e deri në identifikimin e proceseve dhe terminologjive të përngjashme (2).

Kërkimet për një status të qëndrueshëm të identitetit përbëjnë një nga qasjet më të rëndësishme të studimit të personalitetit në tri dekadat e fundit (3). Burimet e mëdha të identitetit variojnë në shkallët e rëndësisë: burimet më të prekshme shfaqen në sjelljet dhe përkatësitë e individit, ndërsa burimet më pak të prekshme ndërtojnë tiparet e personalitetit tonë.

Patologjitë e ashpra të personalitetit jetojnë në një kontinuum me personalitetin normal.

Në të dyja rastet përfaqësuese, shihet ruajtja e aftësisë për testimin e realitetit.

Teksa në personalitetin normal funksionaliteti është i përshtatur dhe fleksibël, në patologjitë e personalitetit kemi të bëjmë me ngurtësi dhe keqpërshtatje.

Tiparet tona të personalitetit janë pjesërisht të krijuara nga mbrojtjet që ne përdorim në mënyrë të pavetëdijshme automatike dhe në mënyrë të përsëritur në rrethana të ndryshme. Fleksibiliteti dhe funksioni përshtatës i personalitetit normal pasqyrojnë edhe natyrën fleksibël të operacioneve mbrojtëse të personalitetit të shëndetshëm dhe të maturuar.

Nga ana tjetër ngurtësia që karakterizon nivelet e personalitetit patologjik, pasqyrojnë mos përqasjen e mekanizmave dhe operacioneve mbrojtëse. Individët me personalitet patologjik mbështeten në mekanizmat mbrojtëse të represionit dhe të ndarjes (shpërfytyrimit të imazhit në përfaqësimet e tyre mendore) çka përbëjnë karakteristikat bazë të “nivelet neurotik” të personalitetit të trajtuara në këtë punim. Është pikërisht qëndrueshmëria relative dhe jo fleksibiliteti a mbrojtjet neurotike që kur mvishen me procesin e zhvillimit të identitetit, krijojnë shtresën mbajtëse të ngurtësisë së personalitetit patologjik. Në patologjitë e personalitetit tiparet keqpërshtatëse të personalitetit mund të shfaqen ose si frenuese të sjelljes normale “strukturë frenuese të sjelljes”, ose si teprim i disa sjelljeve “strukturë reaktive sjellore”.

Në shumë individë këto struktura janë të pranishme së bashku. Në rastin e tipareve frenuese të personalitetit, vihen re mangësi të strukturave sjellore që mund të jenë të përshtatshme në një situatë të dhënë. Në tiparet e personalitetit reaktiv kemi praninë e strukturave sjellore që nuk janë domosdoshmërisht të nevojshme për situata të dhëna.

Shtatë elementet e Organizimit të Personalitetit, ku katër nënforma trajtohen në mënyrë të pavarur nga vlerësimi i shkallëzuar, përfshijnë: *Integritetin*, me të cilën nënkuptohet aftësia për të parë veten në qëndrueshmëri, kompleksitet dhe përshtatshmëri; *Marrëdhëniet me objektin* ose aftësinë për të ruajtur marrëdhënie të afërta, të qëndrueshme dhe të kënaqshme; *Tolerancën ndaj afektit*, ose aftësia për të përjetuar tërësinë e emocioneve të lidhura me zhvillimin e individit; *Rregullimi i afektit*, ose fleksibiliteti në përdorimin e strategjive përballuese; *Integrimi i superegos* ose aftësia për të përdorur një ndjeshmëri morale dhe të maturuar; *Testimi i aftësisë së kuptimit të realitetit* ose aftësia për të vlerësuar perceptimet e realitetit dhe *Resilienca e egos* ose aftësia për të reaguar dhe rimarrë veten nga burimet e stresit.

Argumentet mbështetëse mbi Organizimin e Personalitetit shihen fillimisht në bazën e mendimeve të psikanalizës (4), që dallonte tipet e hershme “primitive ose predipiale” dhe tipet “më të integruara edipiale” të psikopatologjisë. Në varësi të tipeve të psikopatologjisë, janë të dallueshme gjithashtu

edhe nivele të ndryshme të zhvillimit të psikopatologjisë.

Autorët (5) në studimet e tyre metanalitike kanë instrumentalizuar këto dallime në literaturën psikanalitike dhe kanë parashtruar disa tipare bërthamë në përcaktimin e niveleve të Organizimit të Personalitetit.

Studime të tjera në këtë linjë nga (6) tregojnë se niveli i Organizimit të Personalitetit lidhet me rezultatet e trajtimit dhe mund të jetë parashikuesi i vetëm i rëndësishëm si në dekursin e patologjisë, ashtu edhe në reagimin ndaj trajtimit. Një dallim tjetër ndërmjet qasjes së nivelit të Organizimit të Personalitetit dhe qasjeve diagnostike DSM dhe ICD, është se në këto të fundit nuk qartësohet një lidhje shkakësore mes strukturës së personalitetit dhe çrregullimeve të personalitetit.

Në studimet e saj, autorja (7) ka arsyetuar se akset përshkruese dhe niveli i Organizimit të Personalitetit janë të pavarura nga njëri-tjetri. Çdo formë e patologjive të personalitetit mund të shfaqet në nivele të ndryshme të Organizimit të Personalitetit. Ndryshe nga studiuesit e linjës së parë psikodinamike, një tjetër autor ka parashtruar një Model të Dy-Polariteteve të Organizimit Prototipik, model i cili bashkërendon qasjet e diagnozës dhe trajtimit në lëmin e klasifikimit psikodinamik. Në vazhden e qasjeve teorike për çrregullimet e personalitetit, dëmtimin në nivelet e vetes dhe të tjetrit, autori (8) ka argumentuar si në këndvështrimin përshkrues, edhe në pikëvështrimin teorik, se problematikat e personalitetit karakterizohen para së gjithash nga vështirësitë në marrëdhënie dhe problematikat me përcaktimin e vetes që vendosen në këtë kontinuum dy-dimensional, të cilin ai e trajtoi si Model të Dy-Polaritetit.

Modeli i propozuar nga në vitin 2008 argumenton se marrëdhënia dhe përcaktimi i vetes janë dy dimensionet thelbësore psikologjike që krijojnë matricën teorike për kuptimin e proceseve të zhvillimit të personalitetit; shumëllojshmërinë e organizimit të personalitetit normal; konceptet e krijimit të psikopatologjisë dhe integrimin e mekanizmave të veprimit terapeutik. Funksionimi i mirë i personalitetit për të (9) përfshin ekuilibrimin e zhvillimit të marrëdhënies ndërpersonale dhe përcaktimit të vetes. Andaj, nivelet e maturuara të marrëdhënies lehtësojnë zhvillimin e qëndrueshmërisë së identitetit, autonomisë dhe kuptimit të vetes, që nga ana e tyre ndikojnë në marrëdhëniet ndërpersonale të integruara. Gjatë zhvillimit, përvojat traumatike dhe predispozita biologjike mund të krijojnë shpërftyryme të linjës së zhvillimit të individit dhe neglizhimin e marrëdhënies me tjetrin. Nëse i referohemi qasjes së Prototipit të përshkruar në këtë studim problematikat psikopatologjike mund të mendohen si *Prototipa* në modelin dy dimensional. Prototipi i çdo individit në nivele të ndryshme të zhvillimit (10) pasqyron mënyra unike (prototipa) të zgjidhjes së ekuilibrit të marrëdhënies dhe përcaktimit të vetes që shkojnë nga “*funksionimi i personalitetit normal*” deri te “*problematikat e plota dhe nivelet e çrregullimeve të personalitetit*”. *Prototipat e personalitetit* përbëhen nga struktura hierarkike multidimensionale dhe përfaqësojnë

një tërësi më të plotë përshkruesish sesa përcaktuesit e thjeshtë të frikës, ankthit, dëshpërimit etj. Prototipat janë tipologji abstrakte, pasi ato nuk përbëjnë kategori specifike. Gjithashtu, numri i formave prototipa të zgjidhjes së konfliktit, që mund të përdorë individi, është i kufizuar. Kufijtë ndërmjet prototipit janë të kalueshëm, çka e lejon individin të përdorë tipare nga prototipa të ndryshëm. Në mjedisin klinik, spektri i prototipave përbërës të një personaliteti mund të ndikojë zhvillimin e personalitetit në formën e ndërveprimit sinergjik të përvojave të marrëdhënies dhe përcaktimit të vetes, të përvojave të afërsisë dhe ndarjes, të ngjashmërive dhe papërshtatshmërive dhe forcimit të këtyre ndërveprime (11) sipas parimit “zinxhir”. Sikundër na argumenton kumpti filozofik (12) në “Tematikën e Dasein”: Qenia ime është qendra ku përqendrohet ekzistenca. Ne jemi gjithnjë të lidhur nga qenia dhe të lidhur me “qenien tonë”. Është një parametër jetësor për ne. Është pikërisht kjo qenie ndaj të cilës jam i interesuar, që lidh *mënyrat e mia të mundshme për të qenë*. Këto mënyra të të qenurit përbëjnë *mundësitë e mia*. Ekzistenca është kësajsoj qëndrimi mbi mundësitë e vetes.

Klasifikimi i kategorive mendore përmes Manualit Psikodinamik Diagnostik (PDM) dhe lidhja e psikolinguistikës me të

Në perspektivën psikodinamike arritja e një kuptimi të qëndrueshëm e pozitiv të vetes, si dhe vendosja e një marrëdhënieje reciprokisht të kënaqshme dhe jetëgjatë, janë me gjasa dy detyrat thelbësore të zhvillimit të individit.

PDM e klasifikon shëndetin mendor në dy fusha të mëdha:

I. Modele të Personalitetit (Aksi- P)

II. Funksionimi Mendor (Aksi-M)

Studimi i nivelit të organizimit të personalitetit ose ashpërsinë e çrregullimit të personalitetit qëndron në linjën e parë të PDM-së. Ky manual bazohet në të dhënat e fundit të neuroshkencës, të trajtimit dhe hulumtimeve empirike që kanë treguar se strukturat emocionale, sjellore, sociale dhe të funksionalitetit përfshijnë një gamë të gjerë fushash të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Studimet kanë vënë në dukje rëndësinë e analizës dhe interpretimit të tërësisë së strukturave emocionale dhe sociale. Studiuesit, si (13), treguan se natyra e marrëdhënieve psikoterapeutike së bashku me aspektet operuese të mendjes dhe trurit mund të parashikojnë më shumë rezultate sesa çdo qasje tjetër trajtimi. Natyra dhe gama e parashikimeve është në qendër të strukturave të organizimit në Manualin Diagnostik Psikodinamik. PDM trajton tërësinë e zhvillimit njerëzor: të rriturit, adoleshentët, fëmijët dhe të vegjlit. Pjesa diagnostike e të rriturit në të cilin është mbështetur ky studim, fillon me personalitetin e tij. *Aksi –P i Modeleve të personalitetit dhe çrregullimeve* është

vendosur fillimisht në sistemin e PDM, pasi të dhënat e grumbulluara dhe simptomat e tyre nuk mund të kuptohen ose trajtohen në mungesë të një kuptimi të thellë të tipareve të personalitetit të të rriturit mbartës.

Aksi-P trajton dy fusha me një diapazon që shkon nga një *personalitet i shëndetshëm* (mungesë të një çrregullimi të personalitetit) në një *nivel neurotik* të çrregullimit të personalitetit. Nivelet e organizimit të personalitetit (i shëndetshëm, neurotik, borderline dhe psikotik) përcaktohen nga vlerësimi i aftësive të dikujt. Këto aftësi përfshijnë: *maturitetin dhe identitetin, aftësinë për krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve të qëndrueshme, rregullim i afektit, arsyetimin moral, testimin e realitetit dhe aftësinë për të reaguar dhe u rehabilituar nga stresi*. Pas përcaktimit të të gjithë nivelet të organizimit të personalitetit, ne marrim në shqyrtim modelet e personalitetit të Aksit-P që mund të jenë të përshtatshme (në minimumin e dëmtimit), ose në çrregullim të personalitetit të qëndrueshëm (që shkaktojnë dhimbje të përsëritura për veten dhe të tjerët).

Më pas, Aksi-P i PDM merr në konsideratë secilin çrregullim të personalitetit sipas strukturave të temperamentit, tematikave, afektivave, kognicioneve dhe strukturave mbrojtëse. Problematika qendrore apo shqetësimi parësor është manipulimi dhe të qenurit i manipuluar. Afektet kryesore të këtij personaliteti janë *inati dhe zilia*. Besimi patogjen karakteristik për veten është : “*Unë mund të bëj gjithçka*”. Besimi patogjen karakteristik për të tjerët është: “*Të gjithë janë mendjemëdhenj, manipulues dhe të pandershëm.*” Manuali klasifikon një çrregullim të personalitetit depresiv me nëntipin e introjektivit (vetë-kritikut), analitikut (reaktiviteti i lartë ndaj humbjes dhe refuzimit) dhe me manifestimin e përkundërt: çrregullim i personalitetit hipomaniak (karakterizuar nga energjia e lartë, kundër depressive, frikë nga afërsia etj.). PDM gjithashtu na jep sugjerime të trajtimit kur kemi të dhëna të mjaftueshme. Tipi introjektiv i përgjigjet më mirë interpretimeve dhe insight-it, ndërsa tipi analitik i përgjigjet më mirë marrëdhënies terapeutike sociale të tashme. Bazuar në këto prerogativa të mëdha, studiues të Universitetit të Sapienza në Romë (14) krijuan një listë prej 19 çrregullimesh prototip psikanalitike të lidhura me katër themele të personalitetit. Autorët integruan këto kategori në Tabelën Psikodiagnostike (15) që vlerëson personalitetin në katër elemente bazë : 1) i shëndetshëm, 2) neurotik, 3) borderline, dhe 4) psikotik.

Dimensioni i dytë i PDM, Funksionimi Mendor i **Aksit-M** jep një pamje të detajuar të aftësive që kontribuojnë në personalitetin individual dhe nivelin e përgjithshëm të shëndetit psikologjik ose të shqetësimeve. Aftësitë në Aksin M mund të përfshijnë: *aftësinë për rregullim, vëmendje dhe të nxënë; aftësia për krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve* (përfshirë thellësinë, shtrirjen dhe konsistencën); *cilësinë e përvojave vetjake* (niveli i besueshmërisë dhe vetë-përfaqësimit); *aftësia për krijimin e përvojave afektive, shprehja dhe komunikimi; niveli i përdorimit të modeleve mbrojtëse; aftësia për të formuar përfaqësitë e brendshme; aftësia për të diferencuar dhe integruar; aftësia-vetë-vëzhguese* (mendësitë psikologjike) dhe *aftësia për mbajtjen e standardeve të brendshme*

dhe idealeve që përfaqëson një ndjesi të të moralshmes. Secila nga aftësitë e përshkruara janë përkthyer në pohime specifike në këtë studim. Identiteti normal bashkëshoqërohet me një përvojë të vazhdueshme në kohë dhe hapësirë për veten dhe tjetrin e rëndësishëm, si dhe me aftësinë për të vlerësuar atributet dhe përvojat e brendshme të të tjerëve në thellësi, kompleksitet dhe plotësi.

Ky identitet është gjithashtu i shoqëruar me aftësinë e individit për të investuar në kohë mbi interesat e veta profesionale, intelektuale dhe krijuese. Ky dinamizëm linjëzohet sipas vlerave, opinioneve, shijeve dhe besimeve të individit. Individët me patologji të identitetit klinik paraqiten me një problematikë të dukshme në konceptimin e përvojave të vetes dhe të botës. Identiteti patologjik klinik shoqërohet me copëzim dhe paqëndrueshmëri të kuptimit të vetes dhe përvojës së tjetrit të rëndësishëm në kohë dhe hapësirë. Përvoja subjektive (**Aksi –S**) e individit për veten dhe të tjerët është e varfër, me mangësi të thellësisë, sipërfaqësore dhe e polarizuar.

Shijet, opinionet dhe vlerat janë jo lineare, të marra nga të tjerët përreth mjedisit dhe mund të zhvendosen lehtësisht. Individit me patologji të identitetit ka mangësi në aftësinë e kuptimit të të tjerëve dhe nuk mund të reagojë ndaj çështjeve shoqërore që e rrethojnë. Përpos shfaqjes së qartë të kësaj forme të identitetit patologjik në DSM, *çrregullimi i personalitetit borderline*, një sërë patolgjish të tjera të identitetit karakterizojnë pjesën më të madhe të çrregullimeve të ashpra të personalitetit. Në formën e vet ekspresive të së paravetëdijshmes, gjuha është entiteti lidhës ndërmjet mendimit dhe ndërveprimit të jashtëm e të brendshëm. Strukturat tona gjuhësore lidhen domosdoshmërisht me energjinë psikodinamike të strukturave të personalitetit dhe aftësive ndërvepruese të secilit personalitet mëvetësisht. Funkcioni themelor i gjuhës, sipas studimeve psikolinguistike (16), nuk është korrektësia që mund të përbëjë një nga qëllimet e shumta për të cilat njerëzit flasin, por arritja e çdo shkëmbimi të vërtetë energjik i ardhur nga ndër-materializimi i ndërsjellë. Ne komunikojmë jo vetëm sepse flasim të njëjtën gjuhë, por duke vepruar mbi simbolet dhe kuptimet e saj, mbajmë të hapura kanalet komunikuese që na lejojnë zhvillimin e gjendjes së bashkëbisedimit dhe ndërmjetësimit psikik. Përdorimi i fjalëve është një veprim dhe ndërveprim, jo vetëm kur ne krijojmë e mbartim fjalë, por edhe kur i kujtojmë ato në mendje e kur zhytemi në mendimet tona në dialogët e brendshëm. Një tjetër autor (17) e zgjeroi studimin e tij mbi dimensionin social të gjuhës, bazuar në shumëllojshmërinë e qëllimeve dhe funksioneve që shpreh gjuha.

Ai identifikoi *gjashtë* funksione të gjuhës, që vijojnë:

- *Referenciale*: ligjërimi i referohet diçkaje të saktë dhe të qenësishme të informacionit që përmban mesazhi;
- *Emocionale* (ose ekspresive): ligjërimi nxjerr në pah një gjendje përgjigje të qenësishme të mendjes, emocioneve, ndjenjave, identitetit;
- *Lodhje o kontakt*: ligjërimi vë në dukje vazhdimësinë e komunikimit;
- *Imperative*: ligjërimi përcjell një urdhër;

- *Metalinguistike*: ligjërimi shërben për të përcaktuar shenja të tjera si përdorimi i gjuhës për të përshkruar veten dhe strukturat kognitive të mëvetësishme;
- *Eстетike*: ligjërimi tërheq vëmendjen në mënyrën se si fjalët përdoren, duke komunikuar kryesisht nëpërmjet formës së tyre.

Funksioni ndërmjetësues i gjuhës lidh egon dhe botën, ose qeniet njerëzore brenda botës materiale dhe jo-materiale. Përfaqësimi i një objekti në mënyrë që të bëhet koncept, duhet të jetë objektiv, por procesi i objektivizimit realizohet vetëm përmes ndërmjetësimit të gjuhës dhe ky i fundit merr formë vetëm brenda fjalës. Në fakt, egoja nuk është në një individ abstrakt dhe transcendent, por në një anëtar konkret të një kolektivi që përcaktohet në marrëdhënien me tjetrën (18). Prandaj, objektivizimi bëhet si linguistik në ndërsjelltësinë, në reciprocitet dhe në dialog. Në përgjigjen e tjetrit jo vetëm që egoja e njeri botën, tjetri nga vetja, por edhe vetë. Funksioni i gjuhës shprehet në marrëdhënien objekt-objekt, si një shembull ndërmjetësues midis egos dhe botës dhe mbi të gjitha në marrëdhënien subjekt-subjekt, sipas një modeli dialogjik të dijes. Gjuha nuk mund të kuptohet vetëm si proces *poiesis* (teorik), por kryesisht si proces *praxis* (praktik). Objektizimi i mendimit ndodh vetëm nëpërmjet gjuhës, më saktësisht kur fjala kthehet, i reziston Egos të shprehur nga Tjetri-Ti. Objektizimi i subjektivitetit gjenerohet kështu në dialog, sepse në dialogun ku ata takohen, Unë dhe Ti njohim njëri-tjetrin, objektet marrin formë dhe bashkimi i këtyre objekteve përbën botën. Objektiviteti në dialog është gjithmonë ndërsjelltë dhe ndërsjelltësi psikik përçohet vetëm përmes strukturave psikodinamike të organizimit të personalitetit dhe gjuhës.

Përfundime

Gjuha, komunikimi dhe marrëdhënia njerëzore-sociale janë format kryesore që ndërveprojnë në varësi të njëri-tjetrit dhe në të njëjtën kohë plotësojnë një përbërje të veçantë sociale, e cila analizohet dhe artikulohet në organizmin psikodinamik. Gjuha nuk konsiderohet më thjesht si një sistem i tingujve dhe një sërë rregullash gramatikore, por është studiuar në marrëdhënien e subjekt-objektit që e përdor atë, duke u bërë kështu një instrument komunikimi dhe ndërveprimi në jetën shoqërore. Kontekstet psiko-edukuese dhe psiko-linguistike përcaktohen dukshëm nga terminologjia dhe përcakton kuptimin e ligjëritimit që i ndikojnë ata në mënyrën se si bashkëbiseduesit bashkëveprojnë brenda tyre dhe në botën shoqërore. Manuali Psikodinamik Diagnostik si formë taksonomike e organizimit të personalitetit dhe e tendencës së qenies ndaj të vetëdijshmes dhe të pavetëdijshmes, paracakton kufirin e objekt-subjektit si formë dhe përmbajtje nominative dhe dimensionale. Qenia e njeriut, pas një identikiti të tillë Prototip, bëhet pjesë e jetës shoqërore përmes komunikimit jo vetëm si proces subjektiv, por edhe si proces që gjeneron marrëdhënie ndërmjet entiteteve psikike të ndryshme. Andaj, ne mund të pohojmë se komunikimi gjuhësor i jep formë jetës individuale si një dimension psikologjik dhe jetës shoqërore si dimension social në tërësinë e ekzistencës së vet.

Referenca

1. Gecas, V. dhe Burke, P. J. (1995). *Self and Identity*. Gjendur në Comparing psychological and sociological approaches to identity: identity status, identity capital and the individualization process, Cote' E. James dhe Schwartz J. Seith, *Journal of Adolescence*, 2002, 25, fq. 572-586 www.ideallibrary.com
2. House, R. J. (1977). 'A 1976 theory of charismatic leadership', Gjendur në J.G. Hunt and L.L. Larsen (eds), *Leadership: The Cutting Edge*. Carbondale, IL: Southern Illinois University Press.
3. Marcia, J. E. (1966). Development and validation of ego identity status. *Journal of Personality and Social Psychology*, 5, fq. 551-558.
4. Freud S. (1932), *Introduzione alla psicoanalisi (nuova serie di lezioni)*. Gjendur në *Veprat/ Opere*, botimi italian, vol. 11, Boringhieri, Torino 1979, fq. 121-284 referuar Freud 1920.
5. Caligor, E.dhe Clarkin, J. F. (2010). *An object relations model of personality and personality pathology*. Gjendur në J. F. Clarkin, P. Fonagy, dhe G. O. Gabbard (Eds.), *Psychodynamic psychotherapy for personality disorders. A clinical handbook* (fq. 3–35). Washington, DC: American Psychiatric Publishing.
6. Kernberg, O. F. dhe Caligor, E. Levy. (2005). A psychoanalytic theory of personality disorders. Gjendur në J. F. Clarkin & M. F. Lenzenweger (Eds.), *Major theories of personality disorder (Botimi i dytë, fq. 114–156)*. New York: Guilford.
7. McWilliams, N. (2011). *The Psychodynamic Diagnostic Manual: An effort to compensate for the limitations of descriptive psychiatric diagnosis*. *Journal of Personality Assessment*, 93(2), fq. 112–122. <http://dx.doi.org/10.1080/00223891.2011.542709>
8. Koeelen JA, Luyten P, Eurelings Bontekoe LH, Diguier L, Vermote R, Lowyck B dhe Bühring ME. (2012). *The impact of level of personality organization on treatment response: a systematic review*. *Psychiatry*, 75(4), fq. 355-374.
9. Blatt, S. J., Stayner, D., Auerbach, J. S. dhe Behrends, R. S. (1996). *Change in object and self representation in long-term, intensive, inpatient treatment of seriously disturbed adolescents and young adults*. *Psychiatry*, 59, fq. 82-107.
10. Livesley, W. J. (2003-2004). *Practical management of personality disorder*. New York: Guilford Press.
11. Skodol, AE dhe Bender DS. (2003). *Why are women diagnosed borderline more than men?* *The Psychiatric Quarterly*. 74(4), fq. 349–360.
12. Blatt, S. J. dhe Luyten, P. (2009). *A structural-developmental psychodynamic approach to*

- psychopathology: Two polarities of experience across the life span.* Development and Psychopathology, 21, fq. 793–814.
13. Blatt, S. J. dhe Shichman, S. (1983). *Two primary configurations of psychopathology.* Psychoanalysis and Contemporary Thought, 6, 187-254.
 14. Safran, J. D., Muran, J. C., dhe Eubanks-Carter, C (2011) *Repairing alliance ruptures*, Psychotherapy, 48(1), 80-87.
 15. Safran, J. D., Muran, J. C., Samstag, L. W., dhe Stevens, C. (2002). *Repairing alliance ruptures II.* Gjendur në J. C. Norcross (Ed.), Psychotherapy relationships that work. New York, NY: Oxford University.
 16. Heidegger, M. (1976). *Essere e Tempo.* Botimi i njëmbëdhjetë, fq. 27, fq. 42, fq. 128, fq. 182 (A cura di Pietro Chiodi) Longanesi & C., Milano.
 17. Gazzillo, F., Gordon, R.M., Lingardi, V., Del Corno, F., Bornstein, R. F., dhe McWilliams, N. (2014). *Empirical research with Psychodynamic Diagnostic Prototype (PDP) and the Psychodiagnostic Chart (PDC): Towards PDM-2.* National Meeting of American Psychoanalytic Association, New York, fq. 14–19.
 18. Humbolt W. von. (2000). *La diversità delle lingue*, Roma-Bari, Laterza.